

## Fillimi i një shërbimi informativ në shumë gjuhë

27.03.2020



Departamenti për integrim dhe diversitet i qytetit të Vjenës, nga e hëna, me 30.03.2020 gjatë krizës së Coronës ofron një shërbim informativ shumë gjuhësh.

Na dërgoni pyetjet tuaja në lidhje me krizën e Coronës në gjuhën tuaj amtare, Ne do të hulumtojmë për ju, nëse ka përgjigje tashmë të disponueshme nga burime të besueshme. Ne do t'ju kontaktojmë me informacione në gjuhën tuaj amtare.

### **Pyetjet tuaja mund ti parashtroni këtu**

- Email: [post@ma17.wien.gv.at](mailto:post@ma17.wien.gv.at)
- Facebook: [startwien.at](https://www.facebook.com/startwien.at)
- Telefon: 014000 81540 (Na telefononi dhe na tregoni se në cilën gjuhë dëshironi të bëni pyetjen. Njëri nga punonjësit tanë me siguri do t'ju thërrasë)

### **Kur mund të na kontaktoni**

Nga e hëna deri të premtën, nga ora 9:00 deri në 16:00. Ne do të përpiqemi që të ju përgjigjemi pyetjeve tuaja mbrenda 24 orëve..

### **Ne nuk mund të përgjigjemi në çdo pyetje**

Punonjësit pranë departamentit të integritit dhe diversitetit në qytetin e Vjenës nuk janë eksperte të Coronës. Sidoqoftë, ne do të përpiqemi të sigurojmë informacione nga burime të besueshme në gjuhën tuaj amtare. Nëse nuk kemi informacione nga burime të besueshme për pyetjet e bëra, ne për fat të keq nuk mund t'u përgjigjemi atyre. Ju lusim për mirëkuptim.